



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 126 paragrafi 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 20 të Rregullës nr. 01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, nenit 12 paragrafi 1 germa (b), të Rregullës nr. 14/2015, Mbi Financimin Subjekteve Politike dhe Sanksionet, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2019, merrë këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e gjobës

- I. Partisë Politike, "Partia Demokratike e Unitetit -PDU", i shqiptohet gjobë në shumën prej treqind e pesëdhjetë (350) euro, për dorëzim me vonesë të të dhënave të ndryshuara vjetore, pas afatit ligjor prej njëzet e gjashtë (26) ditëve.
- II. KQZ-ja, i transferon të gjitha pagesat administrative në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftojë Partinë Politike, "Partia Demokratike e Unitetit - PDU", për pikën I të këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e saj të radhës, ka marre vendim që të gjobitë partinë politike "Partia Demokratike e Unitetit – PDU", sipas nenit 12 paragrafi 1 germa b) të Rregullës nr. 14/2015, Mbi financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet.

Partia politike, "Partia Demokratike e Unitetit – PDU", nuk ka përmbushur në afat ligjor obligimet që dalin nga neni 11 të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht afati për dorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore ka qenë më 31 janar 2018.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 63 paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 6 paragrafi 5, të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2019, merr këtë :

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit për pezullim

- I. Partia Politike, "**Partia Demokratike e Unitetit**" me akronimin PDU, shfuqizohet nga pezullimi i regjistrimit.
- II. Obligohet Zyra që ta njoftojë Partinë Politike, "**Partia Demokratike e Unitetit -PDU**" për pikën I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e saj të radhës, ka marrë vendim që të shfuqizoj vendimin e dates 2.03.2018, me numër protokoli 251-2018, për pezullim të partisë politike "**Partia Demokratike e Unitetit -PDU**" pasi janë evituar arsyet që kanë shërbyer si bazë për pezullim dhe janë plotësuar kërkesat conform nenit 6 6 paragrafi 1 germa cc) të Rregullës nr 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Partia politike "**Partia Demokratike e Unitetit -PDU**", në afat shtesë prej gjashte (26) ditësh ka dorëzuar të dhënat e ndryshuara vjetore sipas vendimit të KQZ-së, bazuar në nenin 11, të Rregullës nr. 01/2013.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete DAKA

